



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 1142/1 Prishtinë 31-03 2021

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Herolindë Dautaj, ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “Analiza e sjelljes së rameve me mbushje muraturë në modele të ndryshme dhe efekti i shkallës së zvoglimit të modelit nën veprimin e ngarkesës ciklike”, në programin e studimeve Master konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

#### ABSTRACT

Qellim kryesor i këtij studimi është vlerësimi teorik i sjelljes së ramëve me nja hapësirë drite pa dhe me mbushje murature dhe me shkalle të ndryshme të zvoglimit. Në kuadër të këtij studimi janë analizuar gjithsejtë 33 rama me shkalle të zvoglimit 1/1, 2/3 dhe 1/3. Në setin e pare janë trajtuar 15 rama beton arme ndërsa në setin e dyte janë trajtuar 15 rama BA me mbushje murature. Ramat BA të prototipit për të dy setet janë projektuar bazuar në kodet evropiane.

Gjithashtu është trajtuar edhe një rast specifik i rames me mbushje për të dy shkallat e zvoglimit 1/1 dhe 2/3, një dhe dy kateshe. Projektimi i këtyre ramave është bërë duke përdorur murature të forta dhe rama të buta.

Rezultatet analitike të këtyre ramave në japin edhe vlerësimin mbi ndjeshmërinë e këtyre strukturave për shkalle të ndryshme të zvoglimit si dhe ndikimin e mekanizimit përfundimtar në ndjeshmërinë e këtyre rezultateve. Derisa tek strukturat, ku mekanizmi përfundimtarë determinohet nga rami beton shkalla e zvoglimit ose kthimi i rezultateve nga modeli në prototip nuk ndikon në saktësinë e tyre të strukturat që mekanizmi përfundimtarë varet edhe nga mbushja murature ndjeshmëria e kalimit të rezultateve nga modeli në prototip është me e madhe. Për me shumë këto rezultate krahasohen edhe me rezultate të autoreve tjerë.

Fjalet Kyce: Ramat BA me mbushje muratur, prototipi, modeli,

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.